



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 28, datë 06.03.2024

**PËR MIRATIMIN E FAMILJES SPAHO, SI SUBJEKT PËRFITUES NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH, RRUGA "ISMET NANUSHI", PALLATI NR.12/2, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale", Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104, datë 08.07.2022, Urdhërit nr. 164, datë 26.05.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, të raportit të Komisionit të Posaçëm miratuar nga titullari i institucionit me nr. 2712 prot, datë 26.02.2024, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**



1. Miratimin e familjes Spaho, si subjekt përfitues nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth, rruga "Ismet Nanushi", pallati nr.12/2, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	PRONARI	GJENDJA FAMILJARE SIPAS CERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QE PERFITON
1	ISMAIL SPAHO, GURAZIJE SPAHO, MENTOR SPAHO, EDLIRA SPAHO	2	1 + 1

2. Familja Spaho do të përfitojë nga programi i procesit të rindërtimit të Zonës së Re për Zhvillim në Njësinë Administrative Manëz, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 730, datë 16.09.2020, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Manëz, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese” i ndryshuar.
3. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 03.02.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth, rruga “Ismet Nanushi”, pallati nr.12/2, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, shfuqizohet.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**




**U shpall sot me datë 07.03.2024**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 162 / prot.  
114

Durrës, më 13.03.2024

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**



**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.28 datë 06.03.2024 “Për miratimin e familjes Spaho, si subjekt përfitues nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë administrative Sukth, rruga "Ismet Nanushi", pallati nr.12/2, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

